



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 419/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha, Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Hoxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Valon Ramadani, nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Valon Ramadani kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV me seli në Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën me datën 30.06.2017 në ora 14:00, nga parashtruesi i ankesës Valon Ramadani - Kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV me seli në Ferizaj.

Në ankesën e parashtruar pretendohet se në shkollën e mesme të lartë "Ahmet Hoxha" në vendvotimin VV nr. 2501D/09R, dyshojmë se është bërë një gabim, te kandidati me nr.86 nga radhët e subjektit politik LVV.

Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë vendvotim kemi informacion nga vëzhguesit se kandidati me nr. 86 i ka 21 vota, ndërsa sipas gjitha gjasave është bërë gabim teknik, sepse votat e numëruara nga kandidati me n.86 janë shënuar tek kandidati me nr. 84.

Parashtruesi i ankesës ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur kopjet e Formularëve të Rezultateve për Kandidatët FRK.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuara

PZAP-i, konstatoi se ankuesi sipas ankesës ka kërkuar që në vendvotimin VV nr. 2501D/09R, dyshojmë se është bërë një gabim, lidhur me numërimin e votave për kandidatin Valon Ramadani me nr.86 nga radhët e subjektit politik LVV.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore te parashtruesit të ankesës gjeti se ankesa nuk ka asnjë provë bindëse për ta dëshmuar pa rregullsitë e pretenduara në vendvotimin VV nr. 2501D/09R. Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe te pa argumentuar me fakte bindëse pasi qe nuk i plotësojnë kërkesat ligjore te përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit te Panelit pretendimet ankimore te parashtruesit të ankesës është e pabazuar ngase ne ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës. Ndërsa, provat e parashtruara në ankesë sipas vlerësimit të Panelit nuk paraqesin referencë ligjore në mbështetje të pretendimeve në ankesë e as bazë të vlefshme ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për ankuesën.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankes, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si e tillë ankesa e parashtruesit refuzohet.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.419/2017 më datën 02.07.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*